



Numërimi final për klasën e vitit 2030 ka filluar zyrtarisht!

Këtë pranverë, nxënësit tuaj të klasës së 8^{te} do t'i kërkohej të zhvillojë një kalendar të punës që i nevojitet për të përmbushur kërkesat për diplomim nga Utica Community Schools dhe për të planifikuar për kolegjin dhe karrierën.

Jemi të frymëzuar të punojmë me ju ndërsa përgatitemi për kapitullin e ardhshëm të përvojës arsimore të nxënësit tuaj. Më poshtë janë disa pika të rëndësishme për t'u pasur parasysh ndërsa përparojmë në këtë proces.

Xello është Çelësi: Kur nxënësi juaj filloi ciklin shkollor Junior High, ne i kërkuam të fillonte të mendonte për ëndrrat dhe interesat e tyre të cilat konsiderohen si një pikënisje për identifikimin e një plani për jetën e tyre pas diplomimit.

Nxënësit dhe prindërit e UCS-së kanë qasje në një mjet unik planifikimi të quajtur Xello, të cilin e kemi përdorur për të analizuar përgjigjet e fëmijës suaj dhe kemi filluar të krijojmë një plan udhëzues për t'a ndihmuar atë të arrijë qëllimet që ka për të ardhmen.

Rëndësia e përvojave të zgjeruara: Bizneset dhe kolegjet duan që kandidatët e tyre të ardhshëm të kenë një histori të pasur me përvoja të ndryshme që u lejon të ofrojnë perspektiva unike për organizatat e tyre. Si qarku i dytë më i madh shkollor i Michigan-it, Utica Community Schools ofron një seri të pasur opsionesh për të mundësuar këto përvoja.

Programet e specialitetit dhe shkollat tona të mesme të përgjithshme: Për çfarëdo ideje që ju mund të keni, në kemi një kombinim të përshtatshëm për fëmijën tuaj. Shkollat tona të mesme renditen lart në rang kombëtar, me një nivel të arritjeve të nxënësve që e tejkalon mesataren shtetërore dhe kombëtare. Përveç kësaj, UCS ofron pesë programe specialiteti që plotësojnë nevojat unike dhe stilet e të mësuarit të nxënësve tanë.

Bëni pyetje/Ndiqui UCS Pathways to Success: Ju jeni një partner i rëndësishëm. Ne kemi përfshirë një pasqyrë të kërkesave të diplomimit të UCS në këtë letër. Ne gjithashtu, do t'ju dërgojmë informacione të përditësuara ndërsa përparojmë në këtë proces tranzicioni. Nëse keni pyetje, në çfarëdo momenti, ju lutemi ndihuni të lirë të kontaktoni këshilltarin tuaj ose zyrën tonë të shkollës.

Për më shumë, ju inkurajojmë të merrni pjesë në eventin "UCS Pathways to Success" që do të zhvillohet tek Henry Ford II High School të Martën, në 9 Dhjetor 2025 në orën 18:00. Një broshurë rreth këtij eventi unik do t'ju dërgohet edhe nëpërmjet postës sonë.

Familja UCS do të jetë me ju gjatë gjithë kohës. Shkollat tona punojnë së bashku për të krijuar një bazë të fortë që do të sigurojë suksesin e nxënësve për vitet e tyre në ciklin e mesëm dhe më tej. Për këtë arsye, niveli ynë i diplomimeve të suksesshme është ndër më të lartët në rang shtetëror dhe kombëtar.

Katër vitet në vijim, kanë një reputacion të lartë, të merituar, si vitet më të mira në jetën e të rinjve tanë. Ne premtojmë që, këto katër vite do të kenë një ndikim mbresëlënës dhe do të përgatisin nxënësin tuaj të arrijë ëndrrat dhe shpresat që ju keni pasur për ta që kur filluan të frekuentonin kopshtin e fëmijëve.

Sinqerisht,

Utica Community Schools Board of Education

Mary K. Smolenski, Ph.D. - President • Denyeal Nesovski - Vice President • Michael Austerman- Trustee
Kelli Rankin - Secretary • Kimberly Becker - Trustee • Steven R. Meyer Ph.D. - Treasurer • Machel Fitzpatrick - Trustee

Robert S. Monroe
Drejtori i Pergjithshëm i Qarkut

Utica Community Schools Board of Education

Mary K. Thomas. Ph.D. - President • Denyeal Nesovski - Vice President • Michele Templeton - Treasurer
Kelli Rankin – Secretary • Kimberly Becker - Trustee • Steven R. Meyer Ph.D. - Trustee • Machelie Fitzpatrick - Trustee